



Komiteti për Politikë dhe Financa
01.Nr.IV
Deçan,dt.26.04.2024

PROCESVERBAL

I mbajtur për mbledhjen e IV-të të rregullt të KPF-së , me dt.26.04.2024.

Në mbledhje merrnin pjesë: 6 anëtar të KPF-së (mungon Hyri Dobrunaj), drejtori i Drejtorisë për Administratë, Jashar Dobraj, drejtoresha e Drejtorisë për Buxhet dhe Financa, Dafina Cacaj, Zyrtarja për Informim, Edone Kameraj.

Mbledhjen e kryesoj dhe e udhëhoqi, kryesuesi i KPF-së, zotëri Hajdar Sutaj.

Për mbledhje ishte propozuar dhe u miratua ky Rend i punës:

1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;
2. Shqyrtimi i raportit financiar për periudhën 01 Janar- 31 Mars 2024;
3. Ridestitim i mjeteve buxhetore nga Mallra dhe Shërbime në Subvencione;
4. Raporti i mbledhjes së parë të vitit 2024 të KKSBB-së;
5. Shqyrtimi i propozim vendimit për hartimin e Strategjisë dhe Planit të Veprimit për Dhunën në Familje;
6. Shqyrtimi i kërkesave
7. Të ndryshme

Kryesuesi- e hapi mbledhjen e IV-të të rregullt të KPF-së për vitin 2024, verifikoj pjesëmarrjen e anëtarëve të KPF-së, në të cilën merrnin pjesë 6 anëtarë (mungon Hyri Dobrunaj) dhe konstatoj se ka kuorum të mjaftueshëm për mbajtjen e mbledhjes, pastaj e prezantoi rendin e punës dhe e hapi debatin rreth tij, meqenëse nuk kishte të interesuar për debat, Kryesuesi e qiti në votim rendin e punës, i njëjti miratohet njëzëri.

I.Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.

Miratohet procesverbali njëzëri pa vërejtje.

II.Shqyrtimi i raportit financiar për periudhën 01 Janar- 31 Mars 2024.

Florim Mataj- propozon që të përcillet për kuvend, atje debatohet rreth tij.

Vatan Istrefaj-kërkon sqarim për pagesat te Zyra e Kuvendit, çka janë Shërbime konsulentë, pagesa në shumën prej 1868 € dhe pagesa prej 3800€ nga Mallra dhe shërbime.

Yllarta Thaqi- kërkon sqarim te shpenzimet në zyrë të kuvendit.

Drejtoresha, Dafina Cacaj- sqaron se janë pagesa të komisioneve që janë paguar nga mallra dhe shërbime te Zyra e kuvendit, për të njëjtat dokumentacionin komplet do ta sjelli në Kuvend ka thënë ajo.

Rekomandim:KPF e kanë shqyrtuar raportin financiar për periudhën 01 Janar- 31 Mars 2024, ku është kërkuar sqarim për disa nga shpenzimet, pas sqarimeve të dhëna nga drejtoresha, Dafina Cacaj, raporti përcillet për shqyrtim në kuvend, dokumentet për pagesat e komisioneve prezentohen në Kuvend nga drejtoresha Dafina..

III.Transferim i mjeteve buxhetore nga Mallra dhe Shërbime në Subvencione.

Kryesuesi- e ka prezentu piken, pastaj për sqarime fjalën ia kalon drejtoreshës, Dafina Cacaj, e cila sqaron se bëhet fjalë për pagesën e 85 euro cent për Ndërmarrjen Higjiena, për të cilat kuvendi ka

marrë vendim që të paguanë komuna për Tarifën e konsumatorëve shtëpiak-amvisëri, ku qytetari paguan 6 euro ndërsa komuna është zotuar se do ti mbulon shpenzimet prej 85 cent.

Vatan Istrefaj thotë, a ka mundësi N."Higjiena" mi pru një raport qe tregon saktë se janë ba këto shpenzime., kërkon faturë të specifikume qe janë bërë 50.000 euro shpenzime, ai shton se edhe atëherë kur është miratuar në kuvend nuk kam qenë i pajtimit për këto 85 cent, pastaj kërkon që përfaqësuesit e N."Higjiena" të vijnë me raport në kuvend sepse nuk është respektuar rregullorja për Shërbime Publike në këtë rast.

Faton Selmanaj- kërkon sqarim deri kurë vlenë kjo mënyrë e pagesës, e cekur në faq.2. ku thotë "Kjo mënyrë e pagesës vlenë deri në një vendim tjetër të Kuvendit".

Drejtoresha, Dafina- thotë, se ju e kini miratua , unë vetëm e kam zbatua.

Vatan Istrefaj- propozon që të rishikohet ky vendim dhe të hiqen krejt ato 85 cent.

Florim Mataj- jam dakord që ta ftojme përfaqësuesit e N."Higjiena" dhe ta paraqesin një plan si do të funksionon kjo çështje sepse edhe kështu nuk shkohet.

Drejtoresha, Dafina, sqaron se borgji për faturat është ma i madh se 80.000 euro, por për momentin ti ndajmë këto 50.000 euro.

Rekomandim: KPF e shqyrtuan kërkesën nga Zyra e kryetarit, me të cilën kërkohet transferim i mjetëve buxhetore në shumën prej 50.000 euro nga kategoria Mallra dhe shërbime në Subvencione, të nevojshme për pagesën e faturës për NPL "Higjiena" në shumën prej 85 euro cent për çdo faturë në muaj, te kategoria e konsumatorëve shtëpiak-amvisëritë, nga buxheti i komunës së Deçanit, sipas vendimit të Kuvendit të dt.29.12.2022. Gjatë debatit u tha se kjo tarifë duhet të rishikohet ose të hiqet 85 cent dhe te mbetet 6 euro pagesa në muaj, te kategoria e konsumatorëve shtëpiak-amvisëritë. Pas shqyrtimit, KPF këtë pikë njëzëri e përcjellin për shqyrtim dhe miratim në Kuvend.

IV.Raporti i mbledhjes së parë të vitit 2024 të KKS-së;

Rekomandim: Njëzëri kalon si pikë për shqyrtim në Kuvend , pa debat.

V.Shqyrtimi i propozim vendimit për hartimin e Strategjisë dhe Planit të Veprimit për Dhunën në Familje;

Rekomandim: Njëzëri kalon si pikë për shqyrtim në Kuvend , pa debat.

VI.Shqyrtimi i kërkesave.

1.Kërkesa e Shkumbin Malaj, në emër të komunitetit të fshatit Strelc i Epërm, për mbështetje financiare për mbulimin e shpenzimeve për aktivitetin e dhurimit të gjakut në fshatin Strelc i Epërm, i cili mbahet me dt. 25 Maj, shuma e kërkuar1,000.00€.

2.Kërkesa e komunitetit të fshatit Carrabreg i Epërm, për mbështetje financiare për mbulimin e shpenzimeve për aktivitetin e dhurimit të gjakut në fshatin Carrabreg i Epërm, i cili mbahet me dt.29 Maj, shuma e kërkuar1,500.00€.

Anëtarët e KPF-së, pas shqyrtimit këto dy kërkesa i miratojnë njëzëri.

3.Kërkesa e Riza Tolaj, kryetar i Këshillit të fshatrave Prilep dhe Prekolluk, në emër të banorëve të fshatit Prekolluk, , kërkesa e dt.23.04.2024, nr.01-12723, për ndarjen e mjeteve financiare , në shumën prej 5,000.00 euro për projektin e ndërtimit të shtëpisë së përbashkët për aktivitetet e fshatit Prekolluk.

Drejtoresha, Dafina, shprehet se unë jam për, nëse ju e miratoni, vetëm duhet gjete mënyra si ta bëjmë pagesën.

Florim Mataj- thotë se jam për miratimin e kësaj kërkesë, por me kërkesa të njëjta kanë me na ardhë të gjitha fshatrat që kanë këtë nevojë.

KPF njëzëri miratojnë kërkesën prej 5000 euro, për ndërtimin e shtëpisë së përbashkët të fshatit Prekolluk.

4.Kërkesë nga Lidhja e Historianëve të Kosovës "Ali Hadri" dega në Deçan, në shumën 6509 euro.

Rekomandim: KPF e shqyrtuan kërkesën dhe meqenëse shuma e kërkuar i kalon limitet e miratimit nga KPF, ata e përcjellin kërkesën për shqyrtim në Kuvend, atje debatohet dhe vendoset për të.

Kryesuesi- i falënderoj pjesëmarrësit për kontributin e dhënë pastaj e shpalli mbledhjen për të mbyllur.

Procesmbajtëse

Dyke Lllolluni

Kryesuesi i KPF-së
Hajdar SUTAJ



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVA
REPUBLIKA KOSOVA

KOMUNA E DEÇANIT
MUNICIPALITY OF DEÇAN
OPSTINA DEÇAN



Zyra e Kryetarit

02 Nr. _____ /2024 Dt. 20/05/2024

Në bazë të nenit 13 dhe nenin 58 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale të Kosovës (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008), nenit 56 pika 20 dhe nenit 60 të Statutit të Komunës së Deçanit i datës 07.11.2019 me nr. prot. 01/38717, Kryetari i Komunës merr këtë:

PROPOZIM VENDIM

Për formimin e grupit punues për hartimin e Planit për Vlerësimin e Rrezikut në territorin e Komunës së Deçanit.

I. Formohet grupi punues për hartimin e Planit për Vlerësimin e Rrezikut për territorin e Komunës së Deçanit, me këtë përbërje :

1. Izet Zenuni - DMSHSHP / Kryesues ;
2. Gentiana Mazrekaj - DMSHSHP / anëtar ;
3. Shaban Haxhaj - DMSHSHP / anëtar ;
4. Ali Mataj - DMSHSHP / anëtar ;
5. Besim Kameraj - DMSHSHP / anëtar ;
6. Zyra e Kryetarit / anëtar ;
7. Zyra për Informim / anëtar ;
8. Drejtoria për Administratë / anëtar ;
9. Drejtoria për Urbanizëm / anëtar ;
10. Drejtoria për Buxhet dhe Financa / anëtar ;
11. Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale / anëtar ;
12. Drejtoria për Arsim / anëtar ;
13. Drejtoria për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural / anëtar ;
14. Drejtoria për Inspektion / anëtar ;
15. Drejtoria për Ekonomi dhe Zhvillim / anëtar ;
16. Drejtoria për Gjeodezi dhe Kadastër / anëtar ;
17. Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport / anëtar ;
18. NJPZSH / anëtar ;
19. KEDS / anëtar ;
20. K.R.U. "Hidrodrini" – Deçan / anëtar ;
21. N.P.L. "Higjiena" / anëtar ;

2. Ky grup punues ka për detyrë që të hartojë Planin e Vlerësimit të Rrezikut për territorin e Komunës së Deçanit.

3. Obligohet grupi punues që të veprojë në bazë të ligjeve dhe akteve nënligjore të aplikueshme në Republikën e Kosovës.

4. Grupi punues do të fillojë punën menjëherë pas nënshkrimit të këtij vendimi dhe Plani për Vlerësimin e Rrezikut duhet të jetë i gatshëm deri në muajin nëntor 2024.

5. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Drejtoria për Mbrojtje, Shpëtim dhe Shërbime Publike.

6. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit nga ana e Kryetarit të Komunës.

Me vendim njoftohen:

- Anëtarët e grupit punues
- Arkivi i komunës

REPUBLIC OF KOSOVA REPUBLIKA E DEÇANIT	
REPUBLIC OF KOSOVA / REPUBLIKA E DEÇANIT / REPUBLIC OF KOSOVA KOMUNEA E DEÇANIT / DEÇAN MUNICIPALITY	
Wëb Diti Ditë: 02 Ditë: 02	Z. KRYETARIT 15599
Nr. i Dërgimit Ditë: 02 Nd. i Dërgimit	20.05.24
DEÇAN DEÇANE	

Kryetari i Komunës:

Bashkim Ramosaj





REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVA
REPUBLIKA KOSOVA

KOMUNA E DEÇANIT
MUNICIPALITY OF DEÇAN
OPSTINA DEÇAN



Zyra e Kuvendit të Komunës

Nr. 01 / 2024

Dt. 20/05 /2024

ORA 9:00

Për	Kuvendin e Komunës së Deçanit
Nga	Komisioni për Emërtime dhe Riemërtime të Rrugëve, Shesheve, dhe Hapësirave tjera publike.
Lënda	Njoftim mbi punën e deritanishme të Komisionit
Datë	20 maj 2024

Të nderuar anëtarë/e të Kuvendit të Komunës së Deçanit!

Komisioni për Emërtimin dhe Riemërtimin e Rrugëve, Shesheve, dhe Hapësirave tjera publike, në përbërje të:

Hajdar Sutaj

Arjan Dobraj

Dyke Lllolluni

Shkelzen Shehu

Skender Kurmehaj

Orges Tafilaj

Mon Selmanaj

Vjollca Tetaj

Me të kompletuar Komisioni, fillimisht ka marrë rekomandimet e zyrtarëve përgjegjës të ministrisë së Infrastrukturës, dhe Planifikimit Hapësinorë, për hapat që duhet ndjekur në procedurat e komisionit, krejt kjo duke u bazuar në Ligjin Nr.04\L-071, për Sistemin e Adresave dhe Udhëzimin Administrativ MMPH Nr.14/2019 për Caktimin e Emërtimit dhe Numërtimit të Adresave për Zona të Qarkullimit Publik, Ndërtesa, Shtëpi dhe Parcela Kadastrale të Lira, të aplikuara për procedurat e emërimeve dhe riemërtimeve të rrugëve, shesheve, e hapësirave tjera publike.

Pastaj kemi pranuar të gjitha dokumentacionet nga përbërja e mëparshme e komisionit, te legjislaturës se Kuvendit (2021-2025).

Meqenëse ligji parashih vetëm marrjen e emrave nga lista rezerve që e miraton Kuvendi, me emra të propozuar, e pasi që listës ekzistuese vetëm sa i ishte kaluar afati i të qenurit në fuqi, Komisioni filloj me listimin e emrave të propozuar nga qytetaret, për ta kompletuar listën rezervë.

Komisioni gjatë kësaj periudhe, ka thirrur në takim dhe ka takuar për 3 herë radhazi Kryetarët e Këshillave të Fshatrave, duke i njoftuar me procedurat, si dhe afatet e dërgimit të kërkesave nga këto këshilla, apo qytetarë.

Brenda afatit të përcaktuar (e që sipas kërkesave të këshillave të reja, ishte zgjatur edhe për 3 muaj plus) Komisioni ka pranuar për shqyrtim 235 kërkesa me propozime për emërtimin e rrugëve.

Pas kompletimit të propozimeve, komisioni ka përpiluar agjendën e daljes në teren, që të vizitohen nga afër çdo rrugë, sipas kërkesës së bërë, bashkë me Këshillin e Fshatit, në mënyrë që të shikohet nga afër gjendja faktike, dhe të shikohet nëse kërkesa në fjale është në përputhje me ligjet në fuqi.

Tanime Komisioni ka verifikuar në teren të gjitha kërkesat e pranuar, deri me tani, dhe është në fazën përfundimtare, atë të analizimit veç e veç, të gjithsecilës kërkesë, dhe vendimit për gjithsecilën kërkesë veç e veç, për futjen apo jo në Listën Rezerve, të propozimeve, të cilat përfundimisht pas aprovimit nga Komisioni, do të aprovoj ose jo Kuvendi i Komunës së Deçanit dhe krejt në fund kjo listë për tu bërë e plotëfuqishme dhe e zbatueshme duhet të marrë edhe miratimin nga Ministria .

Vlenë të ceket që kjo listë do të mbetet në fuqi për 10 vjetët e ardhshme nga miratimi, ndërsa implementimi i propozimeve, do të fillojë në vitin 2029 (vit ky që mund të bëhen edhe ndryshime në riemërtime).

Sipas dinamikës së punës së Komisionit, shpresojmë që Kuvendi i Komunës, në muajin Qershor 2024 do ta ketë në dispozicion listën me emra të propozuar, për tu miratuar nga Kuvendi, si liste rezerve e emërtimeve për 10 vitet e ardhshme 2024-2034. Aty do të kemi mundësi të diskutojmë detalisht për çdo propozim, dhe të analizojmë çdo emërtim.

Me respekt!



KUVENDI KOMUNAL - DEÇAN


Municipal Assembly of Decan

TRANSKRIPTI

DEÇANI

Mbledhjen e Kuvendit të Komunës

(Legjislatura e VII-ë , mbledhja e IV-të në vitin 2024) me
dt.30.04.2024



DEÇAN

e Martë, 30 Prill 2024

Hajdar Sutaj

Kështu, nëse kam mundësi e me na tregua edhe gazetari kosovapress- it, kur jemi të gatshëm me fillu. I nderuar kryetar i komunës së Deçanit, zoti Bashkim Ramosaj. Të nderuar drejtorë të drejtorive. Të nderuar të respektuar kolegë, antar e antare të kuvendit të komunës. E hapi mbledhjen e 4-t të rregullt të kuvendit të komunës së Deçanit, ashtu siç edhe e keni marrë materialin, për rend dite propozoj këtë rendë pune.

1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;
2. Shqyrtimi i raportit financiar për periudhën 01 Janar- 31 Mars 2024;
3. Ridestitim i mjeteve buxhetore nga Mallra dhe Shërbime në Subvencione;
4. Raporti i mbledhjes së parë të vitit 2024 të KKSB-së;
5. Propozim vendimi për hartimin e Strategjisë dhe Planit të Veprimit për Dhunen në Familje;
6. Të ndryshme.

Po ashtu Më lejoni t'ju pyes pastaj për disa pika shtesë, të cilat i propozojmë këtë mbledhje. E kemi dërguar një material, 2 ditë pasi që është ardh material i rregullt që bëhet fjalë për këmbimin e pronës, gjithësisht të ni rrugë në fshatin Dashinoc, që është i njëjti pronarë, po ka figuru në mes toke edhe vetëm e ka ndru destinacionin që e kanë qitë pjesën anësore të pronës së vet.

Poashtu është plotësim ndryshimi i vendimit për caktimin e lokacionit për pishinën gjysmë olimpikë ministria ka kërku ni dokument. Po plotësimi i dokumentit është vendim i janarit. Edhe, më lejoni që pastaj të të ndryshmet ti diskutojmë në 2 pika. Çë është sipas planit punës ni vizitë studimore në Gjirokastër. Dhe po ashtu të diskutojmë për agjentën me data 5 dhe 6 maj që në ditët të cilët Deçani nderon dëshmorët dhe martirët e komunës sonë. Nëse keni diçka për të thënë për rendin e ditës, Ju lus që ti thuni, e hapi si diskutimin, po zoti Orges Tafilaj e ka fjalën nëse ka mundësi regjia me ja kalu fjalën Orgesit.

Orges Tafilaj

Falemnderit kryesus përshëndetje për kolegët. Fillimisht nuk na ka ardh paradite plani për menaxhimin e fatkeqësive natyrore qysh është paraparë me plan punës. Arsyja pse nuk ka ardhë kur pritet me ardhë, edhe pyetja tjetër është, ku jemi me procedurat për anëtarësimin në unionin e bashkive e shqiptare? Falenderim.

Hajdar Sutaj

Falemnderit Orges, sa i përket planit për menaxhimin e mbeturinave e fatkeqësive realisht atëherë kisha kalu fjalën për arsyetimin pse nuk e kemi futur këtë takim? Si pikë e rendit të ditës të drejtori i shërbimeve publike Izet Zenuni. Nëse keni mundësi me e dhez mikrofonit të drejtori.

Drejtori, Izet Zenuni

Mirëmëngjes për të gjithë, mirmëngjes kryetar E arsyja pse u shtye e plani për menaxhimin e fatkeqësive natyrore është se bazë një udhëzimi administrativ duhet të krijohet 1 grup I punës tu fillu prej asamblesë dhe drejtorive përkatëse. Mendoj se materialin për. Formimi i grupit punues edhe draft planin na është i gatshëm thuja po paraprakisht pa i ndjek procedurat nuk mundet me kalu si dokumenti i plotë mbledhjen e ardhshme të asamblesë vijnë propozimet për grupet, grupin punues edhe me fillu punën që ne muajin qershor me përfundue si dokument.

Hajdar Sutaj

Falemnderit drejtor, ndërsa sa i përket pyetjes për procedurat për anëtarësimin në unionin e bashkive shqiptare, meqenëse procedurat duhet të bëhen në emër të kryetarit, kryetari na ka dhënë gjitha autorizimet që me fillua me këto procedura dhe besoj që pas datës 5 dhe 6 maj që i

përmbyllim domethonë ciklin e aktiviteteve të cilat i kemi dhe do ti fillojmë gjitha procedurat, ashtu siç kërkohet që të bëhen pjesë e këtij unioni. Falemnderit shumë dikush tjetër. Atëherë kolegë e qes në votim rendin e ditës kush është për, Falemnderit a ka kundër? A ka apstenim? Konstatoj që mënyrën anonime e kemi votuar rendin e ditës.

I. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.
Kryesuesi, e hapi diskutimin kushdo që ka diçka për të thënë në lidhje me këtë pikë, Orges Tafilaj.

Orges Tafilaj

Falemnderit kryesues, realisht fjalën e mora më shumë për të diskutu punën e transkripteve të 2 mbledhjeve paraprake. Jemi marrë vesh që të përmirësohen edhe ti votojme, ne skemi votu për to hiç. Kështu që kur kemi me votu, apo nuk do i votojmë fare, edhe pyetja tjetër është, meqenëse Dyka prap, duhet mu marr me procesverbalin, atëherë ku është arsyeshmëria që të kemi edhe transkriptim? Paguajmë transkriptim kot.

Hajdar Sutaj

Falemnderit shumë e kemi zgjidhur këtë problem edhe në fund të muajit domethonë muajin që po hyjm do ti votojmë edhe ato transkripte dhe do ta kemi transkriptën ashtu siç duhet, për shkak se na është dasht me i rregullu me qenëse u kan si pervoj fillestare Disa gabime teknike, të cilat ata nuk kanë mujt për mi dhanë kuptim çdo fjalë, edhe pse gjuhësisht e kanë rregulluar por prap se prap pjesa mekanike duhet kapak një lloj përmirësimi dhe e kemi rregulluar prej këtij muaji. E dikush tjetër për procesverbalin. Atëherë e qes në votim procesverbalin e mbledhjes së kaluar kush është për. Falemnderit a ka kundër? A ka apstenim? Konstatoj që në mënyrën anonime e kemi votuar procesverbalin e mbledhjes së kaluar.

Jemi te pika 2- të

II.Shqyrtimi i raportit financiar për periudhën 01 janar-31 mars 2024 dhe fillimisht meqenëse kemi drejtoreshën prezente, e kisha lut drejtoreshën për buxhet dhe financa, Zonjën Dafina Cacaj, që ta merr fjalën dhe pastaj e kalojmë të shefat e grupeve dhe pastaj të anëtarëve të kuvendit Drejtoreshë, fjala për juve. e ndizni mikrofoni të foltorja. Me materialin bashkangjitur e keni raportin 3 mujor të shpenzimeve.

Drejtoresha, Dafina Cacaj

Këtë raport si qdo vit janë pagesat që janë bërë tremujorin e 1-rë, janë edhe obligimet e papaguara që kanë përfshirë 2 mujorin e fundit për shkaqe që nuk mundem me bo shpenzime në muajin e fundit e parafundit. Poashtu të bashkangjitje keni sot edhe 1 kërkesë që u kërkua në KPF komisionet cilat janë paguar në tremujorin e 1-rë. Mirëpo cilat komisione janë pagu jau kam bashkangjitur edhe vendimet edhe pagesat e secilit anëtar të komisionit. Ka komisione që nuk janë vetëm prej asamblesë, jonë dhe komisionet të emërohen nga kryetari Dhe nëse keni pyetje në lidhje me shpenzimet, raporti është më ndryshe si herat tjera, për shkak se keni kërkua me pasë të definume ose sa ka mallra qajo drejtori sa ka pagesa të derivateve, sa ka veç e veç për mos me pru tan ata qe kemi pru më herët jam bazuar edhe në komuna të tjera qysh e bin edhe mu ka dok që është zgjidhje më e mirë kjo që e kom pru un ksaj here, falemnderit

Hajdar Sutaj

Falemnderit drejtoreshë shef i grupit të AAK-s, Arjan Dobraj, e ka fjalën, pastaj kalojmë te Grupet tjera

Arjan Dobraj

Falemnderit kryesues i nderuar Sutaj, i nderuar kryetar i komunës së Deçanit, z.Bashkim Ramosaj, të nderuar anëtarë të ekzekutivit. Falemnderit drejtoreshës Zonja Dafina Cacaj për sqarimin në lidhje me raportin financiar tremujor, diçka që vërejtëm si grup është se qartësia e raportit, do të thotë shumë edhe më e detajzume. Në fakt gjë që na ra më shumë sy që do të thot nuk kemi diçka të

paqartë rreth përcaktimit apo ndarjes së pagesave sipas emërtimeve, do të thotë janë shumë të qarta, disa paqartësi të vogla që i pata realisht diskutum ma heret gjëra që i përmende edhe vet, për shkak se ka pas pagesa që janë kryer dhe do të thotë 2 muaj edhe për 2 muajt paraprak që gjithsej ka kap dikun 5 6 muaj me pagesa do të thotë, nuk kemi diçka të paqartë të falënderoj dhe një herë përsëri.

Hajdar Sutaj

Falënderës zotit Dobraj, në emër të grupit LDK- së, Albesa Cacaj e ka fjalën

Albesa Cacaj

Atëherë përshëndetje për të gjithë në emër të grupit të LDK- s ne jemi kundër kësaj forme të cilin është ardh raporti financiar për vitin për 3 mujorin e vitit 2024, raporti financiar është mekanizmi kryesor i monitorimit të buxhetit të komunës, përmes së cilit bëhet informimi mbi ecuritë dhe përmbushjen e planeve të grumbullimit të të hyrave dhe përmbushjes së obligimeve të planifikuara, si dhe mënyrat e shpenzimit të parave sipas natyrës së shpenzimeve dhe kategorive të caktuara buxhetore. Ky raport paraqet 1 raport që ka mungesë të detajuar të informatave financiare dhe rrjedhimisht mungesë të informatave të nevojshme për 1 vlerësim dhe gjykim të drejtë për adresimin e mangësive dhe përmirësimin e proceseve. Auditori i jashtëm për komunën e Deçanit ka dhënë vazhdimisht rekomandime që komuna të ndërmarrë veprime konkrete me qëllim që të reflektojë dhe të ofrojë sigurinë e nevojshme që paraja publike të shpenzohet në përputhje me planifikimin dhe qëllimin e synuar e jo që mjetet e destinuar nga kategoria e investimeve kapitale të përfundojnë te pagesat për vendimet gjyqësore dhe si pasojë e keqplanifikimit dhe keqmenaxhimit të buxhetit nga ekzekutivi komunal. Projektet kapitale, të cilat janë paraparë të fillojnë për periudhën 2024, të mos përfundojnë brenda afatit dhe ato të cilat janë të planifikuara të mos fillojnë fare, sepse buxheti i komunës së Deçanit për vitin 2024 është 12.660.517 euro. Prej tyre 2.536.000 janë ose janë paraparë investime kapitale e që si dëshmi më të madhe se ky raport financiar e tregon se buxheti komunal është shpenzuar te pagesat për vendimet gjyqësore me shumën 2.223.287 euro. Furnizime për zyre për periudhën gjithmonë po flasin tremujore 68.950 euro. Shërbimet këshillëse 53.372 euro. Mirëmbajtje rutinore 43.000 euro shërbimet e veçanta 33.000 euro kompensim brenda vendit 32.000 shpenzime për udhëtime zyrtare, 14.607 euro derivate komuna për 3 mujor ka shpenzuar 9.879 mirëmbajtje e veturave zyrtare 8.000. Shpenzimet e varrimit gjithsej janë 20.279 euro, pastaj telefoni mobile, komuna e Deçanit me 1 buxhet të varfëruar ka shpenzuar 40.547 euro. Pajisje tjera të teknologjisë informative që duhen zemrën nuk di as çfarë saktëson është 34.000 euro, pastaj mirëmbajtje teknologjisë e 12.000 dhe shërbime kontraktuese tjera ky raport edhe 1 herë. E tregon avazin e vjetër të pushtetit. Pra buxheti vazhdon të shpenzohet buxheti i komunës së Deçanit vazhdon të shpenzohet përmes përmbaruesve Privat, me vendimet gjyqësore. Faleminderit.

Hajdar Sutaj

Faleminderit Albesa. Drejtoreshë, Ju keni të drejt me u përgjigj në fund ose masë qdo diskutusi, qysh do që e vlerësoni nëse lajmëroi për fjalë, fjala ju takon juve ose në fund. Prej grupit të vetëvendosjes, Faton Selmanaj.

Faton Selmanaj

Përshëndetje kryesus, përshëndetje për të gjithë Edhe ne si grup nuk pajtohemi me këtë formë të raportit, sepse më shumë se gjysma e tij është shpenzime të shkollave don me tha gjë që po të bon me nënkuptu që veq shkollat po bajn shpenzime Shumë mirë me kthy në formën, e cila ka qenë, unë pata veç një pyetje se spo du me qu ne diskutime hiq përderisa e keni prur në këtë form kamufllazhi kështu për drejtoreshën se kur do të del në faqe forma cila ke deklaruar në mbledhje të komitetit për politikë dhe financa, sepse kam shikuar në faqe, ne faqe nuk është aty, ishin veç raporte vjetore me sa pash. Kështu që nëse priton me na sjell prap në at formë të paktën në faqe e ki obligim me publiku.

Hajdar Sutaj
Falemnderit Faton. Zotri Mon Selmanaj

Mon Selmanaj

Përschendetje kryetar përschendetje zoti kryesues. Të nderuar kolegë. Ky raport i shpenzimeve na ka ardh në 1 formë të re, me shumë pak të dhëna për mënyrën e shpenzimeve të buxhetit. Me përschkrime dhe emërtimet që ne nuk i kemi hasur në raportet e kaluara. Për shembull, subvencionet për entitetet publike dhe jopublike që kap shumën e 32.000 eurove, pastaj shtesa e veçantë për të zgjedhurit çka nënkuptojnë ato, në shumën prej 8.131 euro e disa përschkrime të tjera, për të cilat kërkojnë 1 elaborim më të hollësishëm nga drejtoresha e buxhetit. Kur jemi te zyra e kryetarit. I kemi shpenzime për telefoni mobile 37.287 euro. Nëse këto i përpjestojmë për 90 dit, atëher na del mesatarja që kryetari ka shpenzu telefoni 414 euro në ditë Si mund të shpjegohet kjo? I kemi vendimet gjyqësore. Vendimet gjyqësore i kemi në Total, 2.639.812 euro. Unë kisha pas dëshirë pak a shumë që drejtoresha me na elauburu pak ma thellësisht për këto shifra për këto shpenzime për këto, sepse shka nëse për 3 muaj buxhetit ju ka marrë 2.600.00 e kusur mijë euro, atëherë sa na mbetet ne në 9 muaj të tjer Investimet kapitale. Edhe sa po humb buxheti Kur e kemi trajtu buxhetin e vitit 2023, raport financiar për 2023. Ne kemi kërkuar që të deklaroni drejtoresh se sa kemi mbet dhe borxhet e papaguara vitin 2023, të cilat kanë me u bart atje dhe nuk ke marrë ndonjë përgjigje dhe përgjigjen tash po e shohim që për 3 muaj me vendime gjyqësore përmbaruesi na i ka marrë edhe 2.639.000 euro. Atëherë përschkrimi me kodet ekonomike 13 6 2 0 bie në sy 1 emërtim i ri furnizim me ushqim dhe pije, e jo dreka zyrtare. Furnizim me ushqim a mund të na shpjegoni pak më hollësisht se çka nënkupton furnizim me ushqim dhe pije? Ndërsa jo dreka zyrtare. Se ushqimi dhe dreka zyrtare, drekë zyrtare, shkon njeri edhe për Edhe për ushqim. Që kapin shumën ... shifrën prej 7.322 euro Nëse ju qëk ta 3 muaj i keni ndaluar drekat zyrtare, atëherë ju përgëzoj shumë dhe i mbështes dhe dëshiroj.

Hajdar Sutaj
Falemnderit Zotri Mon Dikush tjetër prej asamblistave. Blinera pastaj Syla. Blinera Loka e ka fjalën.

Blinera Lokaj

Gjatë shqyrtimit të raportit financiar ndër tjerash, vërejmë që është 1 raport i mangët në kuptimin e shkrimit strukturës kjarhtësis si dhe përmbajtjes që e ka. Disa nga gjetjet faktike në këtë raport janë para të shpenzuara për dreka zyrtare e të kamufluara nëpër kode të ndryshme. Pastaj ka kode te paqarta dhe të paspecificuara. Për shembull kod,. Shërbime këshillëdhënëse dhe profesionale, pastaj kodit shërbime kontraktore si dhe shërbime të veçanta dhe kontraktorë individualë. Cili është dallimi në mes të këtyre shërbimeve? Apo kodeve, të cilat në total buxhetit komunal i kanë kushtuar plot 92.000 euro dhe duke u bazuar në këtë raport, ne nuk mund ta dimë sa është pagesa e borxhit të vitit të kaluar apo është tremujorin e parë

Hajdar Sutaj
Falemnderit kolegë Syl Balaj e ka fjalën.

Sylë Balaj

Shpenzimi shkollav Isa Boletini ku thot mirmbajtja e mobilieve dhe pajisjeve 1115 Euro këtu a hyn vendosja e kamerave mirmbajta e kamerave, apo qfar, e kam të pa qart vetëm lexon pajisjet e tjera 1.338 euro, a kanë ardhur pajisje të reja në shkoll Pajisjet e reja në shkollë llaptopa apo diçka se ne dijani ton ska ardh as nje pajisje e re këta 3 muaj

Hajdar Sutaj
Falemnderit Sylë, Vatan Istrefaj

Vatan Istrefaj

Faleminderit Kryesus, përshëndetje për gjithë, Sa i përket raportit financiar, pra shifet qart keqmenaxhimi edhe kësaj radhe, por për të mos u zgatur në diskutim dhe për të mos i cekur të gjitha. Nëse i duket kryetarit që është menaxhim i mirë le të qesh pra. Po shoh e kam paqartësi të telefonua mobile që është afro 40.000 euro shpenzime rreth këtyre 3 muajve. Kërkoj sqarim nga kryetari, pra se qysh erdh gjithë kjo shumë për vetëm 1 periudhë kaq të shkurt. Po ashtu sa i përket sa i përket keqpërdorimeve, po shihet qartë. Edhe qytetarët e kanë kuptuar ku shihet se vetëm përmbartuesi 2 milion dhe atëherë çfarë do të ndodh në pjesën tjetër të investimeve kapitale, por që kemi komunën kur përmbartuesi ti merr për 3 muaj 2.300.000 tash spo jom i sakt në shifër. Po ashtu sa i përket edhe shëndetit primar që e kemi këtu në Deqan Shifet që edhe këtu nuk kemi shpëtuar pa përmbartues. Ku e shohim që për këtë periudhë janë dikund afro 29.000 euro, Vetëm vendime gjyqësore e si pasojë e kësaj keqmenaxhimi, pra kemi mungesë të barnave esenciale në vazhdimësi e për një kohë të caktuar kemi pasur mungesë të shiringave, faleminderit.

Hajdar Sutaj

Faleminderit Veton, Miftar Ahmetxhekaj e ka fjalën

Miftar Ahmetxhekaj

Përshëndetje Kryetar, pa dasht me u nal në ato që i diskutuan kolegët në formën e të shkruarit në ndryshimet e kualifikimet që po du me besu qe mund ta keni 1 sugjerim nga ministria e financave, edhe pse ka paqartësi. Po e them dhe po e ritheksoj, Buxheti i komunës do të duhej të ishte akti ose norma më e rëndësishme për vlersimin tim, referuar këtyre tabelave per mendimin tim kryetari dhe drejtoresha për financa nuk e ka ket vlersim, ket e bazoj në dy parallogaritje shumë të thjeshta Planifikimi buxhetor për vitin 2024 është 12 pikë diçka milion. Nëse i referohem tabelës së ofruar shpenzimet për tremujorin e 1-rë, i keni 5 diçka milion. Nëse këtë kthej në përqindje i bie dikund afër 40% përqind të buxhetit e keni shpenzuar për 3 mujorin e parë Nëse e bëjmë edhe ni kalkulim të thjeshtë tremujorin me 12-të mujor i bjen qe për 25 për qind të kohës të vitit kalendarik. Ju keni shpenzuar dikund përafërsisht 40% përqind të buxhetit. Nëse i kthehem seancës së fundit kryetari i nderum kur unë ju kam pyetur sa është borxhi në momentin që po flasim, edhe pse kjo nuk është evidentume përgjigjja juaj ne procesverbal. Përgjigja ka qenë 180.000 euro. Unë jam kon i vetëdijshëm se pos që është e pa sinqertë është edhe pa sakt si pergjigje. Nese i kalkulojmë shifrat 2 pikë diçka milion vendimet gjyqësore, po du me ta hjek ni katërqind majshte të arsimit kontratave kolektive, megjithëse po du me vlerësu që nuk është faturë e juaj. Kjo i bie nëse ju i paguani çdo tremujor ka 1.8 fundi i vitit. Fundi do të jetë diku përafërsisht 8milion. Pyetja ime konkret edhe në këtë seancë është kryetar i nderum sa është borxhi në momentin që po flasim i komunës të Deqanit, nëse ju prap do më jepni një përgjigje, të pasakt dhe të pa sinqertë këtë do ta kuptojmë pas 3 mujorshit tjetër, faleminderit shumë

Hajdar Sutaj

Faleminderit Miftar, dikush tjetër, Orges Tafilaj e ka fjalën.

Orges Tafilaj

Faleminderit kryesues, realisht, sa herë që e kemi diskutu për raportin financiar, unë kam qenë idhtarë i formimit të këtyre tabelave përmbledhëse po them. Megjithatë besoj drejtoreshë kryetar kishin qenë shumë ma mirë kësaj tabele përmbledhëse ti është bashkangjit edhe raporti i detajuar. Realisht nuk ndashta me e marr fjalën por për shkak të pyetjeve që bëjnë kolegët. Besoj raporti i detajuar i kish jep përgjigje gjith secilit, sidomos te ajo pjesa e faturave utilitare. Unë jam i bindun që ato mjete nuk jan hargjuar në 3 mujor, por jan pagesat viteve paraprake. Kështu që është mirë

tashmë me qenë se the për sot. Do bashkangjitet aty edhe me i pa detajume edhe e besoj ka me na jep pergjigje per secilin ze qe biseduam.

Hajdar Sutaj

Falemnderit Orges, dikush tjetër. Drejtoresha për buxhet dhe financa e ka fjalën, Dafina Cacaj.

Dafina Cacaj

Raporti e thash që publikohet sod, e kam prit asamblen, edhe te obligimet e papaguara kan qenë te publikume në fillim të vitit, komplet borxhi i vitit të kaluar, sa janë obligimet e papaguara se edhe ato e kemi obligim me publiku Te ushqimet dhe pijet. Ushqime dhe pije jo dreka zyrtare nënkuptojnë pijet që paguhen n' bife që i marrim edhe ushqimet që merren te shpia rezidenciale për personat që jetojnë atje nuk mundem me shkru ata drekt zyrtar se nuk është drekt zyrtarësh, por është furnizim me ushqim dhe pije për ata. Edhe për kërkesat tona nëse kemi. Telefonia, është pagese, që unë nuk kam mundur me bo 2 vjet e fundit hiqë, për këtë arsye është 40.000 mij, telekomi deri tash nuk më ka bër presion dhe ata qe nuk me bejn presion nuk ju jepi perparsi I kam paguar menjëherë që ka dal buxheti komplet faturën e 2 viteve për këtë duket pak ma e madhe se që duhet me kanë, I kam paguar një pjesë, nuk mujta me i pagu te gjitha, edhe i kom paguar momentin që e kam pas buxhetin. Dallimet mes kodeve vlerësim, sikur është, Shërbime kontraktuale ose shërbime. Individuale, perfshihen komisionet, përfshihen shërbimet e ndryshme që bën që u bë vlerësimi i pronave, paguhen me të njëjtin kod. Kontratat në vepra dhe shërbime tjera kontraktuale që kemi pas gjatë vitit të kaluar ose që jan mbart me kontrata deri në këtë vit. E mobilje dhe pajisje tjera qe e pate shembull në Isniq është pajisja e kamerave në shkollën e Lëbushës, për këtë arsye dyqan ti munesh mem ndihmu ma shumë për arsim. Une e di që ajo pagesë është për këtë arsye se Lëbusha është dege e Isa Boletinit ne Isniq, Po. Edhe te plani kontabël edhe ni herë po lidh te kodet, jon kode që na duhet me u përshta, t unë mundem me jau sjell edhe emailin që e kemi pas ftesën, jemi shkue zyrtaret e financave, e kanë mbajtë trajnimin me ministrinë e financave për ndryshimet që iu bënë fundvit në fuqi nuk u hi deri këtë vit edhe jon kode që na duhet më përshtat Edhe nese najher ndoshta nuk i përafrohet sikur është mobilje dhe pajisje tjera, osht kod i përbashkët për krejt ato. Pagesat që bëhen të asaj natyre edhe nuk e kemi bo na, na vetëm përshtatemi asaj që na kanë pru prej nivelit qendror.

Hajdar Sutaj

Falemnderit drejtoreshë. I. Falemnderit per sqarimet dikush tjetër prej atyne që s'kanë diskutu nuk është lajmëru. Atëherë ne e kalojmë si pikë të rendit të ditës dhe jemi në pikën e 3-të.

II. Ridestnimi i mjeteve buxhetore nga mallra dhe shërbime në subvencione.

Pra lus drejtoreshën për buxhet dhe financa znj Dafina Cacaj që të na jap sqarimet e nevojshme në lidhje me këtë pikë të rendit të ditës dhe pastaj hapim diskutimin. Drejtoresh është fjala për juve.

Drejtoresha, Dafina Cacaj

Për shkak se të hyrat e bartura nuk barten me vendim të asamblesë, nëse nuk kemi tejkallim me ligjë të buxhetit osht fjala për këtë vit që është i votuar mundet në vitin tjetër me ndryshu me ardh apet. Por për këtë vit vetëm nëse komunat kanë tejkallim të mjeteve të planifikuara, të risjellin në asamble Unë nuk e kem pas tejkallume planin e planifikume dhe nuk e kom sjell në asamble Mjetet janë aloku në ato kodet që kan qenë të planifikume vjetë dhe ka pas hapësirë që kanë qen të paplotësuara ne mallra, shërbime, kom pasë, hapësirë më të madhe. Këto kode janë planifiku janë aluku, mjetet po na 50-të mijë euro. Po kërkojmë prej qati kodit mallra shërbime me i transferu në subvencione për borxhin që ia kemi ndërmarrjes publike Higjiena, që u votu vjet në asamble. Unë jam zotu që nuk kam mjete po apet u votue dhe nuk kam mundur ta paguaj deri tash, tash po du me e pagu bile borqin e vitit te kalur që mos me mbet obligim I vazhdueshëm, nuk kam pasur mjete më shumë. kërkoj falje mallra për me mujt me kry obligimin deri në ditën e sodit. Po vetëm të vitit të kaluar.

Hajdar Sutaj

Falemnderit shumë drejtoreshë në emër të grupit AAK-s Yllarta Thaqi ka kërkuar fjalën Apo në emër të grupit. në emër të AAK-s.

Yllarta Thaqi

Sa i përket 50 mije eurove dashta pak me u ndërlidhë me këto, se vitin e kalum kur e kemi votu unë e kam abstenuar, për arsye se më është dukur tarifa shumë e lartë për qytetarët, ndërsa i ka mbet barr 85 centë komunës së Deçanit. Mbas është edhe kryetari Këtu na votojnë për shkak se higjiena është 1 shembull më i mirë i komunës Deçanit. Deshta me e pyet deri kur ka me vazhdu ky 85 cent për me mbet mbarë komunës së deçanit, apo sepse këtu shkruhet deri në 1 vendim të ri. Jemi pro kësaj se higjiena është 1 ndërmarrje e cila na ka bo me u ndi mirë të gjithëve është shembulli i suksesit është shembulli i mirëmbajtjes, qytetit dhe fshatrave, por mos është ngarkesë për komunën e deçanit 85 cent, ndërsa nëse tarifohet ekonomive familjare, është barrë shumë e madhe se asnjë komunë nuk e ka 6.85 cent Falemnderit shumë Yllartë, Miftar Ahmetxhekaj nga LDK-ja .

Miftar Ahmetxhekaj

Përshëndetje dhe një herë kryetar më kujtohet mirë dhe kështu besoj se nuk më tradhton memorja kur e kemi aprovu kët rregullore si grup kemi pasur atëherë dilemat dhe realisht kemi qenë kundër për 2 arsye, e 1-ra për vlerësimin tonë ka qenë 1 barrë për qytetarin. Domethënë, është rritur një tarif që unë po mendoj se as qytetet e kosovës më të urbanizume nuk e kanë këtë tarifë. Dhe e 2-ta për vlerësimin tonë ka qenë plus 1 barrë për komunën e deçanit dhe më kujtohet mirë dhe saktë që kur i kam shtrru pyetjet qysh keni me i ngjit emrin. Këtij çmimi kësaj tarife dhe ju nuk keni pas ni përgjigje të sakt dhe tash na del që po dashkan në subvencione. Unë kryetar i nderum aq sa kuptoj dhe aq sa di subvencionet Janë para të cilat japin organizatat buxhetore për individët apo për institucionet për rimëkëmbje, për të vazhduar ne veprimtari për 1 kohë të caktuar. Unë nuk kom dëgju në jetën time në përvojën time që subvencioni lahet për borxh osht gabim Dhe këtu ju bëj thirrje që kët rregullore me ndryshu këtë tarifë me hjek. Për 2 arsye e para me e lehtësu qytetarin dhe e 2-ta me ju lehtësu juve ish dash dhe do duhej higjienia të rimëkëmbet higjienia ta baj vetveten ju i keni dhënë aksione duhet ta dini u jam përsërit shumë herë në raport me këtë temë edhe frigothem qe ma marin pak për të keq absolut nuk kam asgjë subjektive, jam shumë objektiv në kët situat është gabim me subvencion. Me subvencion paguhet borç është gabim edhe per ket gabim, ne jemi kundër dhe nuk e mbështesin këtë.

Hajdar Sutaj

Falemnderit shumë prej grupit vetëvendosjes. Orges Tafilaj e ka fjalën

Orges Tafilaj

Falemnderit Kryesues. Realisht unë prita që para anëtarëve para shefav grupeve parlamentare Anëtarët e kuvendit që marin fjalën në emër të grupeve me diskutu anëtarët e komisionit e komisionit të aksionarëve të ndërmarrjes. Megjithatë na jemi para 1 akti të kryer, 1 vendimi që kena mar si kuvend. Edhe nuk kemi rrugë tjetër pos me votu per sot. Megjithaë drejtoreshën dhe një këshillë miqësisht. Të lutem ku referohesh te pagesat, mos thuaj unë i paguajë se paguhet nga taksat e qytetarëve, paguhen nga gjithë ne këtu, kështu që mos i personalizo gjerat. Falemnderit.

Hajdar Sutaj

Falemnderit shumë Orges, Mon Selmanaj e ka fjalën.

Mon Selmanaj

Falemnderit kryesues. Atëhere Mendoj që Pak a shumë duhet të debatohet dhe trajtohet mënyra se si është ardh deri te, Deri këtu që mjetet Jo të planifikuara. Për 1 shumë 0.85 në të cilën e ka

kërkuar kryetar i komunës në mbledhjen e vitit të kaluar, në mënyrë që të përmbushet apo të ndahet pjesërisht kërkesa ndërmarrjes publike lokale higjiena në amvisri prej 6 euro dhe 0.85 cent i mbetet barrë Komunës këtë barrë vet. Ekzekutivi komunal e ka kërku dhe mazhoranca. Që sot po thotë e ka miratu. unë në diskutimin e tij e ka mbështet fillimisht vitin e kaluar ndërmarrjen higjiena dhe kërkesën e saj. Mirëpo. Jam qenë kundër që të ngarkohet komuna me 0,85cent sepse diku 60.000 e llogaritsha që do të. Jetë buxheti. Apo shuma përcillen duhet paguar kompania për punët e kryera dhe kur nuk ke mjete të planifikuar, unë e kom ditë, atëherë kom ditë që ne kemi me ardh në 1 situatë që 14 muaj pas. Të mos paguhet për punën e kryer ndërmarrja higjiena, ndërsa e pyes drejtoreshën për vitin e ardhshëm se si do t'ia bëni për vitin e ardhshëm, kur prapë do të vazhdojmë me pagesat 0,85cent ndërsa nuk keni mjete të planifikuara, si mendoni që këtë vit TI kryeni obligimet ndaj kësaj ndërmarrje? Ju falemnderit.

Hajdar Sutaj

Falemnderit zotri Man dikush tjetër. Faton Istrefaj e ka fjalën.

Vatan Istrefaj

Duhet me pas dhe një sqarim shtesë e shoh se tek fakturat që ka sjell për higjiena pra totali i fakturës është 30.000 mijë euro Atëherë pse po kërkohen 50.000 mijë euro që të bëhet ridestini i tyre? 20.000 euro plus tregon për çfarë arsye është kjo shtesë.

Hajdar Sutaj

Falemnderit shumë dikush tjetër. Arjan Dobraj.

Arjan Dobraj

Falemnderit kryesus. Në fakt ne e dimë se ndërmarrja higjiena është krijuar prej asamblesë prej asamblesë kaluar, kështu që nuk nuk po e shoh pse është kaq problematike me përkrahë. Për me ec ose për mbarëvajtjen e kompanisë kur opozita po folin për mbarëvajtje, këta në fakt po e kundërshtojnë mbarëvajtjen e kësaj kompanie. Edhe nuk. Nuk po e shoh çka ka telashe me me përkrahë çfarëdo lloj forme që na krijohet mundësia më e përkrah. Dikur. Jo. Tha dikush nga opozita që është vlera 30.000 mijë ju nëse bëhet fjalë për 9 muajt e 1-rë të vitit kaluar është 38.000, që i bjen edhe 12.000 për 3 muajt e fundit. Atëher bohet 50.000 domethanë Nuk ka telashe nga ana matematikore, thënë kështu. Falemnderit.

Hajdar Sutaj, E ka fjalën Faton Selmanaj

Faton Selmanaj

Falemnderit kryesues. Kolega Arian iu drejtua opozitës, opozita e ka për obligim me kërku llogari. Ndërmarrja higjiena po bohen rreth 4 vite nese nuk gaboj qe osht e themelume Dhe ndërmarrjen higjiena osht duke e mbajtur realisht komuna çdo vit i kemi do me mijëra mijëra euro herë 300.000 herë 200.000 vitin e kalum për kontratën jan ndarë 800.000 euro. Në vazhdimësi ne askpektin financiar është tu e mbajt komuna gjë që ndërmarrja osht dasht me i marr hapat e vet Dhe me pas ni stabilitet dhe një qëndrueshmëri të veten pa u varur shumë prej komunës gjë që nuk është duke ndodhur Tjetra qe dashta me than osht qe kjo barrë buxhetore Dhe në vitin e kalum me 1 kërkesë të kryetarit të komunës ka qenë puro politike. Sepse ka qenë shumë më mirë se kryetarit të ishte realist. Dhe të tregonte të vërtetën mbi ndërmarrjet publike. Problemet financiare që ju kanë faturu Ndërmarrjeve në përgjithësi, sepse është shtrajtuar deponit zbrazi është shtrajtu është 1 plan i ri shtetër i cili pritet Dhe mbi të gjitha ka ndodhe dhe një inflacion i përgjithshëm, gjë që ka rritur vlerën e përgjithshme, kështu qe nje pyetje pata krejt për fund gjë që e kam ba edhe në komisioni për

politikë dhe financa po e bëri dhe kolegja. Në këtë dokument thuhet se kjo mënyrë e pagesës do të vlen deri në 1 vendim tjetër të kuvendit dhe sa mendon kryetar që ky vendim të jetë në fuqi

Hajdar Sutaj

Falemnderit Faton dikush tjetër prej atyre që nuk kan diskutu Syl Balaj.

Sylë Balaj

Pershendetje per te gjith edhe un jam kunder kësaj mënyre pagese nga subvencionet, më mir subvencionet ti përdorin bërë diçka tjetër kur kem gjendjen e Shumë klubeve sportive se është e mjerushme më mir ti ndihmojm ata se sa të paguajm borxhe.

Hajdar Sutaj

Falemnderit shum Arjan tu ka përmendur emri ki drejt 1 minutë replikë, edhe pse është dashur ti me kerkue

Arjan Dobraj

Kam komunikue me ni kolegj prej kuvendit komunal në Gjakovë edhe ne nuk mundem me u tregu ma të meqem se komuna tjera sapo më tha që edhe komuna shpesh e përkrah domethonë kompaninë çabrati me mjete financiare. Çfarëdolloj forme domethën nëse pret ky për 4 vjet na me ec me kamb tona atëher është pak e vështirë kurkur e përkrah komuna e pejes komuna e gjakovës, atëher pse ne me u tregu më te menqur, falemnderit.

Hajdar Sutaj

Nuk tu ka permend emri. Kryetari e ka fjalën kryetari Bashkim Ramosaj. Kryetari Bashkim Ramosaj e ka fjalën. E kuart e kuart E kryetari Bashkim Ramosaj e ka fjalën

Kryetari, Bashkim Ramosaj

Përshëndetje për të gjithë. po mundohem me qen gjithëperfshires në këtë Dilemën që u hap ose Kërkesat që u bën rreth ndërmarrjes higjiene. E rëndësishme është që pom vjen mir qe e kem nje qytet te paster E 2-ta po ashtu ndihem mirë sepse ndoshta e vetmja komunë në Kosovë që kem ndërmarrje komunale e cila merret me ambient. E 3-ta që duhet me qenë objektive, krejt neve osht që me bo qmos që këtë ndërmarrje me maturu edhe ma teper Maturimi i ksaj ndërmarrje ka me ndodh ku ka me kriju produkte të tjera shtesë. A jemi në kohë kur këto Produktet duhet me hy në funksion. Unë besoj që jemi, mirë po e a kemi luksin dhe a kemi krijuar standard për me qen kështu nuk e besoj qe jemi e shikoni qe komplet brenda shtetit tonë nëpër krejt teritorin e Republikës së Kosoves Pamja më e shëmtuar është bërllogu Dhe. Nuk duhet me lën gjë pa bë qe mos me pas berllog A duhet me nxjerr një vendim tjetër që e pezullon këtë vendim? pe bojm një vlersim në rast se nuk ja komplikojmë jetën ndërmarrjes dhe mundemi me i ngarku qytetart me kit taks Ose mundemi me largu krejt. le të bëhet një vlerësim le të bëhet një diskutim osht komisioni i aksionarëve bordi drejtues mundet me bo ni ekspertizë. Unë ju kisha than. me mbështet për shkak se. Osht ni strategji nacionale e cila. Nuk hyn në funksion kurrë dhe unë nuk pres as nuk ka me hy në funksion. Për shkak. Shumë komplikime që po ndodh në këtë pjesë, mirëpo kur do që ndodh, është mirë që na me qen me standardin e duhur. A duhet me pas produkte të kompostimit? Po a duhet me postë produkt të ndarjes në burim mbeturina po a duhet me pas riciklim po a duhet me pos grumbullim mbeturinave inerte riciklim tyne edhe po a duhet me pas 1 automjet transporti që shkon vetëm 1 herë në deponinë rajonale po dhe krejt këto janë kosto? A duhet në pas një ekip e cila shkon nëpër nëpër bjeshk tona për të mbledhur mbeturina? Unë besoj që po a duhet më pas automjeti i cili bën transportin e? Automjetet që parkohen pa leje nëpër trotuar ish dasht edhe kët shërbim me pas, dhe këto nuk bëhen pa e pasur një buxhet Këtu nuk bëhen pa e patur një mirqenje

Unë. Unë qysh do që ta vlerësoni ju kurdo që ta Vlerësoni ju na mundën me diskutu, mirëpo ju kisha ftu të gjithë juve. S'paku shefat e grupeve le ta takojn komisionin e aksionerëve le ta bëjnë ekspertizën le ta bëjn 1 studim dhe ta bini ni përfundim ta bini ni propozim, mirëpo ideja ime është mos me kursye për sa i përket ambient. Dhe. do tema të mdhaja duhet të kryejmë me kalu ni start krejt tjetër si komunë? perndryshe kemi me mbet gjithmonë ne ket rrethin vicioz tu u sjell. Me krejt respektin e perjuve mu mduhet me u largu per një or nga seanca për shkak se kom. Ekipin kombëtar të kërkim shpëtimit këtu dhe e kam themeluar njësi të kërkim shpëtimit malor. e i kam lë në pritje Po kërkoj me mirësjelljes që mem fal pak.

Hajdar Sutaj

Kryetar faleminderit takohum, pastaj vazhdojmë kështu. Koleg jemi larguar pak nga rendi dites, sepse nuk jemi tu diskutuar për mjetet financiare ni pjesë ku jemi tu diskutu për vendimin. Na e kemi me plan të punës domethonë edhe raportin e higjiens atëher mundemi me diskutue ma konkretisht çka duhet për me ndërmar. Poju thonë sinqerisht mundemi pyet gjitha komunat përreth, filloni prej Pejës prej Gjakovës prej Kline prej Istogut prej Prishtinës për çmimet saj i kanë Albesa Cacaj e ka fjalën.

Albesa Cacaj

Fillimisht dua te pajtohem me deklarimin ose konstatimin e kryetarit qe e deklaroi më parë E kam 1 pyetje teper të thjesht se sinqerisht nuk kuptoj me 22 dhjetor 2022 osht ardh ne asamble Kërkesë nga ekzekutivi që të bëhet kjo rritje prej 0.85 cent, edhe pse edhe njëherë peritheksoi që ne si grup parlamentar ldk-s skemi qenë kundër, por edhe drejtoresha në fjalë edhe atëherë edhe sot deklaroi se komuna ose drejtoria për buxhet nuk ka buxhet mjaftueshëm për të mbuluar këte kategori ose këte shpenzim. Atëherë pse është ardh ne asamble meqë nuk e keni bërë planifikimin e mirëfillt me fillim edhe mos me ardh te situata ne te cilen jemi sod që nga Kategoria e subvencioneve dhe mallrave të shkojnë te shlyerja e borxheve në vend që të shkojnë në ndonjë investim kapital ose te subvencionet që bëhen me Shpallje publike në bazë të kriterëve fiton ai qe i permbush. Faleminderit.

Hajdar Sutaj

Kolege sa për me e rikujtue se na mundën iu referuar procesverbalit për me qën më të sakt. Kërkesa nuk ka qenë prej egzekutivit që ne ti ndajm 0.85cent si komun. Kërkesa ka qenë prej ndërmarrjes higjiens që me qenë çmimi 6.85 mandej ne kemi pasur 1 propozim prej grupit të aak-s në atë kohë që 6 mbet tarifa prej që ngarkohen ekonomitë familjare dhe 85 cent mu ngarku komuna në mënyr që te letohët ajo Edhe domethonë na kemi aprovu çmimin për 6.85 momentin që na çfuqizojm këtë 0.85centsh ajo ngarkohet tek Qytetarët. 6.85 Domethonë kaq ishte sapër sqarim Leotrim Hadergjonaj e ka fjalën Jo i fal. Ok. Miftari 1 minutë e ka

Miftar Ahmetxhekaj

Faleminderit shumë kryesues. Nëse i referohem ligjit për ndërmarrjet publike, nëse nuk gaboj neni 5 në momentin që komunat ose aksioneri e themelon 1 ndërmarrje publike, nuk ka detyrim financiar, ndërsa. nëse është më ndryshe. Ma thuani neni 5 i ligjit për ndërmarrjet publike sa i përket subvencionit edhe 1 herë subvencionet zakonisht jepen momentin kur palet konkurrojnë kryesues i nderum dhe konkurrojnë mbi bazën e kriterëve që organizatat buxhetore i vendosi le të konkurron higjiens me organizatat e tjera me ndërmarrje tjera, me kompani me individ dhe i vendosi kriteret e merr subvencionit. Është e pakuptueshme borxh për subvencion, kaq.

Hajdar Sutaj

Faleminderit Leotrim Hadergjonaj e ka fjalën

Leotrim Hadergjonaj

Përshëndetje për të gjithë. Kisha pas ni kërkesë drejtuar për kompaninë higjiena po shoh që nuk ka ardhur askush nga ata që seancën e ardhshëm të asamblesë me na sjell një raport të detajizuar financiar të vitit 2023. Përderisa ne jemi, ne jemi aksionari kryesor i kompanisë higjiena, kompania është pronë komunale. Është mirë me na sjell një raport analitik detajizuar financiar 2023 për pagat, shpenzimet, blerjet. Sepse ne atëherë kur kam votu ket raport për mjau çitë 0.85 cent ka qenë koha, rritjeve të mdhaja çmimeve që ka qenë karburanti 1.90cent tash ka ra 1.30cent Ne kompanisë higjiena ju ndihmoj deri 300.000 në vit 10 prej kontratës asht kan mirë me pru një raport detajizume dhe me pa a kanë nevojë kompania higjiena për këto 50.000 mij euro te komunës Që na tek e fundit papë jemi t i ndihmu çdo vit është mirë natura, sepse edhe këtë herë po e kalojmë, por herën tjetër nuk kalon qoftë se nuk e kemi 1 raport detajizuar financiar dhe ndryshojnë komplet kë udhëzim administrativ

Hajdar Sutaj

Falemnderit Leotrim, drejtori i shërbimeve publike Izet Zenuni e ka fjalën e pastaj Florim Mataj Florimi e ka fjalën pastaj e përmbyll drejtori.

